

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Infermierisë dhe përfaqësues të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastër zhvilluan një aktivitet sensibilizues dhe informues me studentët në kuadër të **Tetorit Rozë**. Ky aktivitet pati si qëllim të rrisë ndërgjegjësimin për shëndetin e gruas dhe rëndësinë e kontrollit të rregullt për parandalimin e kësaj sëmundjeje.

Studentët u informuan mbi risqet, simptomat, ishin pjesë aktive e diskutimeve, si dhe ju dha mundësia për kryerjene e një egzaminimi falas.

Në këtë aktivitet morën pjesë pedagogë, studentë të degës së Infermierisë së Përgjithshme, Infermieri Mami, studentë të degëve të ndryshme, si dhe pjesë e stafit ndihmës akademik.



